



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr. 02/L-50**

**PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR EMERGJENT**

Kuvendi i Kosovës,

Në bazë të Kreut 5.1 (ë) dhe 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/9 e datës 15 Maj 2001),

Me qëllim të vënies së bazës ligjore për rregullimin, përparimin dhe përmirësimin e kujdesit shëndetësor emergjent,

Miraton:

**LIGJI PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR EMERGJENT**

**KAPITULLI I**  
**PËRKUFIZIMET**

**Neni 1**

Termet e përdorura për qëllimet e këtij ligji kanë kuptimet vijuese:

“**Ambulancë ajrore**” nënkupton aeroplanin, helikopterin e përdorur për transportin e pacientëve të sëmurë apo të lënduar të cilëve u nevojitet kujdesi mjekësor.

“**Shërbimi i ambulancës ajrore**” nënkupton dhënien e kujdesit dhe transportin emergjent në, apo nga vendi i ngjarjes për në spital.

“**Auto ambulanca**” nënkupton automjetin motorik të konstruktuar dhe të pajisur në mënyrë speciale, apo një ambulancë ajrore që parashihet të përdoret për transport emergjent të pacientëve.

“**Sistemi i shërbimit emergjent mjekësor**” paraqet sistemin i cili siguron menaxhimin e personelit, mundësive dhe pajisjeve, për një shpërndarje efektive dhe të koordinuar në një hapësirë të caktuar gjeografike, të një shërbimi mjekësor në kushtet e emergjencës, që ndodh qoftë si rezultat i gjendjes së pacientit apo si rezultat i fatkeqësive natyrore apo situatave të ngjashme, shërbim ky që administrohet nga një institucion publik ose privat jo profitabil i cili ka autoritet dhe mjete materiale për të siguruar administrim efektiv të këtij sistemi.

“**Mjek i emergjencës**” është mjeku i cili përveç shkollimit adekuat dhe licencës për punë ka të kryer edhe një stazh të emergjencës të paraparë nga programi i Departamentit të emergjencave mjekësore.

“**Mjek specialist i emergjencës**” nënkupton specialistin i cili ka kryer specializimin nga Mjekësia emergjente, i testuar nga komisioni të cilin e ka autorizuar Bordi Qendror për specializime.

“**Infermier i emergjencës**” është personi i cili përveç shkollimit të mesëm mjekësor ka të kryer edhe kurse trajnimi dhe certifikimin për emergjencë.

“**Infermier kardiak**” nënkupton personin i cili është trajnuar dhe certifikuar në kurset e emergjencës mjekësore dhe ka të kompletuar trajnimin shtesë në MAKJ, të aprovuar nga Departamenti i emergjences mjekësore.

“**Gjendja emergjente mjekësore**”, nënkupton gjendjen me simptome akute, çrregullime psiqike, dhe/ose simptome të abuzimit me substanca abusive, tek të cilat mungesa e kujdesit të menjëhershëm mund të rezultojë me rrezikim serioz të jetës.

“**Departamenti i emergjencës mjekësore**”, është pjesë e Shërbimit të emergjencës mjekësore, i cili merret gjithanshëm me trajtimin e pacientit emergjent, diagnostifikimin dhe stabilizimin e plotë të tij në kuadër të spitaleve regjionale.

“**Departamenti universitar i emergjencës mjekësore**”, paraqet institucionin referent në shërbimin emergjent mjekësor, i cili përveç trajtimit të pacientëve emergjent, ndihmon edhe në përpilimin e Protokolleve, zhvillimin e trajnimeve, specializimin e Mjekësisë Emergjente, ekzaminimin dhe certifikimin e punëtorëve shëndetësor nga kjo lëmi, ndihmon emergjencën mjekësore në nivelin primar dhe sekondar, në resurse humane dhe edukim të vazhdueshëm.

“**Sistemi i komunikimit në Shërbimin emergjent mjekësor–SKEM**”, është shërbimi i ndërlidhjes vertikale dhe horizontale të shërbimeve të emergjencës, që përdor telefonin publik, kodin e posaçëm të radiovalëve tokë-tokë dhe tokë-ajër, si dhe telemjekësinë dhe teknologjinë tjetër bashkëkohore në këtë aspekt, në shërbim të pacientit, të pajisjeve mjekësore dhe personelit mjekësor emergjent.

“**Zyra për Shërbimin emergjent mjekësor në Ministrinë e shëndetësisë**”, është organi kompetent i cili koordinon dhe zbaton politikat shëndetësore të Ministrisë në Shërbimin emergjent mjekësor.

## KAPITULLI II DISPOZITAT THEMELORE

### Neni 2

Me këtë ligj përcaktohet organizimi, veprimtaria dhe financimi i Shërbimit emergjent mjekësor në Kosovë.

### Neni 3

Shërbimi emergjent mjekësor zbatohet në nivel parësor, dytësor, në Qendrat referente për Kosovë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës si dhe në shërbimin Emergjent të Trupave të Mbrojtjes së Kosovës.

#### Neni 4

Kujdesi i shërbimit emergjent mjekësor sigurohet me ushtrimin e veprimtarisë së shërbimeve shëndetësore emergjente dhe punëtorëve shëndetësor emergjent.

#### Neni 5

Shërbimi emergjent mjekësor sigurohet me zbatimin e veprimtarisë shëndetësore emergjente në sektorin publik dhe privat.

#### Neni 6

6.1. Veprimtaria emergjente mjekësore organizohet me qëllim të sigurimit të kujdesit emergjent shëndetësor adekuat për qytetarët, në kushte normale dhe në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme.

6.2. Veprimtaria emergjente mjekësore siguron shërbimin emergjent për qytetarët nëpërmjet të zbatimit të masave dhe metodave bashkëkohore të shkencës së Mjekësisë emergjente dhe të shkencave të lidhura me të si dhe nëpërmjet të ndjekjes të vazhdueshme të rezultateve të tyre.

#### Neni 7

Financimi i kësaj veprimtarie përcaktohet me Ligjin për shëndetësi të Kosovës në linjë të veçantë buxhetore, brenda buxhetit të institucioneve gjegjëse.

#### Neni 8

Shërbimi emergjent mjekësor është veprimtari me interes të veçantë shoqëror dhe Strategjik.

#### Neni 9

Shërbimi emergjent mjekësor siguron dhe zbaton sistemin unik të komunikimit ndërlidhës, përbrenda institucioneve emergjente shëndetësore si dhe ndërlidhjet me institucionet me veprimtari emergjente: me TMK-ën, SHPK-ën, KFOR-in dhe Shërbimin e zjarrfikësve.

#### Neni 10

Shërbimi emergjent mjekësor siguron dhe zbaton sistemin unik informativ.

#### Neni 11

Veprimtaria e Shërbimit emergjent shëndetësor i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale që siguron Ministria e Shëndetësisë nëpërmes Zyrës për shërbim emergjent mjekësor.

### KAPITULLI III PARIMET E SHËRBIMIT EMERGJENT MJEKËSOR

#### Neni 12

12.1. Shërbimet emergjente mjekësore realizohen për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe për qytetarët jo Kosovar që ndodhen me qëndrim të përkohshëm ose janë duke kaluar nëpër Kosovë.

12.2. Shërbimi emergjent mjekësor duhet të realizohet në kohë optimale për pacientë me rrezikshmëri të lartë jetësore. Përcaktimi i kohës optimale duhet të mbështetet në protokollet dhe normat e aprovuara.

12.3. Shërbimi emergjent mjekësor ofrohet pa marrë parasysh rrethanat kondicionuese në bashkëveprim me emergjencat tjera: Zjarrfikësit, SHPK-në, TMK-në dhe KFOR-in.

12.4. Të drejtat e pacientëve duhet të respektohen në pajtim me ligjin në fuqi.

12.5. Përgjegjësia e lartë për diagnostifikim të shpejtë dhe vendim të shpejtë për procedurat trajtuese për pacientët që kanë jetën në rrezik.

12.6. Në shërbimet emergjente nuk duhet të ketë bashkëfinancim. Kompensimin për Shërbimet emergjente e marrin përsipër: Ministria e Shëndetësisë, kompanitë kontraktuese të sigurimeve shëndetësore, donatorët dhe shtetet për qytetarët e vet.

12.7. Financimi i Shërbimeve emergjente mjekësore realizohet sipas Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

### KAPITULLI IV SHËRBIMI EMERGJENT MJEKËSOR

#### Neni 13

Shërbimi emergjent mjekësor zbatohet pa bashkëpagesë për të gjithë pacientët emergjent në institucionet publike dhe private.

#### Neni 14

14.1. Format e Shërbimeve emergjente shëndetësor që zbatohen në institucionet publike dhe private janë:

- a) Shërbimi emergjent mjekësor paraspitalor;
- b) Shërbimi emergjent mjekësor spitalor.

14.2. Shërbimi emergjent mjekësor spitalor përfshinë:

- a) Shërbimin emergjent Mjekësor;
- b) Shërbimin emergjent Traumatik;
- c) Shërbimin emergjent mjekësor Intenziv;
- d) Shërbimin emergjent toksikologjik me Observimin Toksikologjik;
- e) Shërbimin emergjent mjekësor me Observimin Internistik-kardiologjik;
- f) Shërbimin emergjent pediatrik;
- g) Shërbimin emergjent gjinekologjik.
- h) Shërbimi emergjent psikiatrik.

14.3. Të gjitha shërbimet emergjente spitalore bashkërenditen në Departamentin e emergjencave mjekësore të institucionit përkatës.

14.4. Shërbimi emergjent mjekësor përkujdeset për të gjitha entitetet emergjente:

- a) Emergjencat internistike;
- b) Emergjencat infektive;
- c) Emergjencat kirurgjike;
- d) Emergjencat pediatrike;
- e) Emergjencat gjinekologjike;
- f) Emergjencat toksikologjike;
- g) Emergjencat neurologjike;
- h) Emergjencat psikiatrike;
- i) Emergjenca geriatrike
- j) Dhimbjet akute.

14.5. Shërbimi emergjent mjekësor trajton të gjithë pacientët e traumatizuar:

- a) Pacientët e traumatizuar në komunikacion;
- b) Pacientët e traumatizuar në vendin e punës;
- c) Pacientët e traumatizuar në kushte familjare;
- d) Pacientët e traumatizuar me armë zjarri;
- e) Pacientët e traumatizuar me armë të ftohta;
- f) Pacientët me djegie, mbytje në ujë, mërdhirje.

14.6. Shërbimi emergjent mjekësor përkujdeset për rastet:

- a) Tentim vetëvrasje:
  - 1. me armë;
  - 2. me mjete kimike dhe barna;
  - 3. forma tjera të vetëvrasjes.

14.7. Shërbimi emergjent mjekësor përkujdeset edhe për pacientët që simulojnë sëmundje dhe siptome akute

14.8. Shërbimi emergjent mjekësor përkujdeset për qytetarët, popullatën ose një pjesë të popullatës në gjendje të jashtëzakonshme, në bashkëveprim me Zjarrfikësit Policinë dhe TMK-në:

- a) me rastin e fatkeqësive masovike;
- b) me rastin e zjarreve, vërshimeve;
- c) me rastin e tërmetit, rrëshqitjes së dheut;
- d) të shembjes së orteqeve të mëdha të borës;
- e) me rastin e lëndimeve dhe helmimeve masovike;
- f) në rast të bioterrorizmit.
- (g) me rastin e epidemive dhe pandemive eventuale.

14.9. Shërbimi emergjent mjekësor, sipas vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë për gjendje të jashtëzakonshme, bashkë me institucionet emergjente vendore, organizohen për mbrojtjen shëndetësore të popullatës.

14.10. Barnat dhe materiali sanitar i nevojshëm për shërbimet emergjente duhet të jenë në listën esenciale të barnave.

14.11. Të gjitha pajisjet mjekësore për departamentet e emergjencës sigurohen nga Institucionet përkatëse.

## KAPITULLI V ORGANIZIMI DHE ZBATIMI I SHËRBIMIT EMERGJENT MJEKËSOR

### Neni 15

15.1. Shërbimi emergjent mjekësor përbën një organizim unik në kuadër të sistemit të kujdesit shëndetësor.

15.2. Shërbimi emergjent mjekësor organizohet dhe zbatohet në nivelin:

- a) Parësor;
- b) Dytësor, dhe
- c) Qendra referente.

15.3. Veprimtaria në këto nivele realizohet në përputhje me strategjinë shëndetësore dhe politikat e bazuara mbi burimet ekzistuese. (Neni 27, paragrafi 2 i Ligjit për Shëndetësi).

15.4. Shërbimi emergjent mjekësor veprimtarinë e vet e zhvillon 24 orë pandërprerë në të gjitha nivelet.

15.5. Në të gjitha nivelet zhvillohet edukimi i vazhdueshëm profesional.

15.6. Me edukim të vazhdueshëm udhëheq Departamenti i Emergjencave mjekësore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës.

15.7. Në të gjitha nivelet sigurohen barnat nga lista esenciale, barnat tjera dhe materiali Sanitar.

### Shërbimi emergjent mjekësor në kujdesin parësor shëndetësor

#### Neni 16

16.1. Shërbimi emergjent mjekësor parësor organizohet nëpër zona shëndetësore. Zonat shëndetësore në këtë aspekt janë territoret komunale të Kosovës.

16.2. Komunat janë përgjegjëse për zhvillimin e emergjencës mjekësore parësore në zonën e vet shëndetësore, në bashkëpunim me Zyrën për Shërbime emergjente mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë.

16.3. Në Qendrën e mjekësisë familjare, shërbimi emergjent mjekësor vepron si organizim i veçantë- Emergjencia mjekësore.

16.4. Qendra dispeçerike organizohet në qytete të mëdha, ku tejkalohe mundësia e veprimit në qendra mjekësore familjare.

16.5. Ky shërbim veprimtarinë e vet e zhvillon 24 orë pandërprerë, në ndërrime 12, ose 8 orëshe.

16.6. Personeli mjekësor dhe jo mjekësor i Qendrës emergjente në Shërbimin emergjent parësor, përbëhet nga:

- a) Specialisti i Mjekësisë Emergjente;
- b) Mjeku në Emergjencën mjekësore;
- c) Infermier i emergjencës;
- d) Personi i ndihmës.

16.7. Përgjegjës i Emergjencës mjekësore në Qendrën e Mjekësisë familjare është specialisti i Mjekësisë Emergjente. Në mungesë të tij, këtë funksion e kryen mjeku në emergjencë.

16.8. Stafi mjekësor i emergjencës trajnohet dhe çertifikohet prej Bordit Çertifikues të Departamentit të emergjencave mjekësore të Qendrës Universitare. Certifikimi bëhet në kurset e mjekësisë emergjente: mbështetja bazike e jetës, mbështetja e avancuar kardiake e jetës, mbështetja themelore e jetës traumatike, mbështetja e jetës pediatrike, mbështetja e jetës gjinekologjike

16.9. Validiteti i kurseve të emergjencës mjekësore zgjatë dy vjet. Pas skadimit dyvjeçar, stafi riçertifikohet sipas këtij ligji.

16.10. Nëse stafi mjekësor nuk riçertifikohet, konsiderohet i pa autorizuar dhe i pa kualifikuar për punë në emergjencë. Stafi i pa çertifikuar dhe i pa liçencuar nuk mund të punojë në emergjencë.

#### Shërbimi i autoambulancës Neni 17

17.1. Shërbimi i autoambulancës është sektor i emergjencës paraspitalore që merret me me ndihmën dhe transportin e pacientëve të sëmurë ose të lënduar. Ky shërbim duhet t'i plotësoj të gjitha kushtet me resurse dhe pajisje, për transportimin e pacientëve emergjent, i cili mund të jetë shoqëror, të merret me qira ose të privatizohet.

17.2. Secili Shërbim emergjent duhet të ketë në funksion së paku dy autoambulanca për transportin e pacientëve emergjent, të pajisura sipas protokollit. Numrin e autoambulancave e përcakton numri i banorëve të një zone.

17.3. Secila autoambulancë duhet të ketë dëshminë e sigurimit, të lëshuar nga një kompani sigurimesh të Kosovës.

17.4. Asnjë ambulancë nuk duhet të licencohet dhe asnjë licencë nuk duhet përtërirë derisa autoambulanca të ketë sigurim.

17.5. Shërbimi i autoambulancës duhet të organizohet në Bashkësitë lokale si nëndegë e shërbimit emergjent të zonës shëndetësore.

17.6. Shërbimi i autoambulancës për transportin neonatal duhet të plotësoj kushtet e posaçme sipas protokollit për transportin neonatal.

17.7. Secili maternitet në territorin e Komunës, patjetër duhet të krijoj kushte për transportin neonatal.

17.8. Për personelin e autoambulancës duhet të sigurohet trajnim specifik të kujdesit të Emergjencës.

17.9. Shoferi i autoambulancës duhet të trajnohet për kushtet e mirëmbajtjes, ngasjen taktike, sigurimin nga incidentet, komunikimin si dhe të ketë aftësi për reagimin primar. Shoferi duhet të certifikohet në kursin e Mbështetjes bazike të jetës dhe të lejohet që të ndihmojë pacientët nëse paraqitet nevoja.

17.10. Secila autoambulancë duhet të ketë pajisje dhe mjete të komunikimit sipas Protokollit për transportin e pacientëve.

17.11. Shërbimi i autoambulancës për punën e vet i jep llogari Udhëheqësit të Shërbimit emergjent mjekësor dhe Zyrës për Shërbime emergjente mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë.

#### Veprimtaria e Shërbimit emergjent mjekësor parësor Neni 18

18.1. Veprimtaria themelore e Shërbimit emergjent mjekësor parësor është:

- a) Trajtimi i pacientëve emergjent paraspitalor;
- b) Reagimi i shpejtë në thirrje;
- c) Trajtimi i pacientëve në vendin e ngjarjes;
- d) Transporti i sigurt dhe trajtimi gjatë transportit;
- e) Stabilizimi i pacientit emergjent në emergjencë;
- f) Transporti pas stabilizimit deri në Qendrën emergjente.

18.2. Për të zhvilluar këtë veprimtari çdo emergjencë e zonës shëndetësore, së pari duhet të krijoj kushtet themelore sipas Protokolleve për Emergjencë mjekësore paraspitalore të nxjerrura me akt nënligjor.

18.3. Kushtet themelore për veprimtarinë e emergjencës mjekësore janë:

- a) Territori;
- b) Pacientët emergjent;
- c) Hapësira e nevojshme për trajtimin e pacientëve emergjent;
- d) Pajisjet e domosdoshme për trajtimin e këtyre pacientëve;
- e) Autoambulancat për transportin e pacientëve emergjent me të gjitha pajisjet sipas protokollit;
- f) Resurset njerëzore të domosdoshme për punë në emergjencë.

18.4. Territori paraqet hapësirën gjeografike në të cilën shtrihet zona e veprimit të Shërbimit emergjent mjekësor. Në këtë zonë shërbimi emergjent reagon në thirrjet emergjente dhe kryen të gjithë aktivitetin e vet.

18.5. Pacientët emergjent janë pacient të sëmurë akut ose të lënduar rëndë në territorin e zonës shëndetësore.

18.6. Hapësira paraqet lokacionin e nevojshëm dhe të pajisur për trajtimin e pacientëve emergjent dhe emërtohet si Emergjencë mjekësore. Hapësira e Emergjencës mjekësore duhet të ketë qasje të përshtatshme për autoambulancën si dhe qasje të lehtë për karrocë të invalidëve. Hapësira e emergjencës duhet të ketë komoditet të mjaftueshëm për lëvizshmëri të personelit dhe pacientëve pa penguar të tjerët. Domosdoshërisht duhet bërë ndarja në bokse për emergjencë mjekësore dhe Emergjencë traumatike.



18.7. Pajisjet mjekësore janë mjetet me të cilat bëhet diagnostifikimi dhe trajtimi i Pacientëve emergjent. Këto pajisje duhet të jenë:

- a) Pajisjet për emergjencën Mjekësore;
- b) Pajisjet për ambulancë.

18.8. Pajisjet dhe mjetet për Emergjencën mjekësore dhe për ambulancë duhet të kompletohen sipas Protokollit për pajisjen e emergjencës mjekësore dhe ambulancës të hartuar nga Departamenti i Emergjencave Mjekësore.

18.9. Resurset njerëzore të emergjencës mjekësore janë punëtorët mjekësor (Mjeku, Specialist i Mjekësisë emergjente, mjeku në emergjencë, infermieri ose infermierja e emergjencës), dhe punëtorët jo mjekësor (shoferi i ambulancës, punëtori higjienist, bartësi i emergjencës).

#### Neni 19

Veprimtarinë e Shërbimit të Emergjencës mjekësore, kualitetin e punës profesionale, dhe vlerësimin e popullatës në lidhje me këtë shërbim e vlerëson Autoriteti Shëndetësor komunal dhe Zyra për Shërbime emergjente mjekësore.

#### Neni 20

Emergjencia mjekësore duhet të këtë Sistemin komunikues i cili shfrytëzon komunikim skringing:

- a) lidhjen me zë;
- b) Numrin e telefonit publik të emergjencës mjekësore;
- c) Lidhje komunikuese direkte me personelin;
- d) Telemjekësinë.

#### Qendra emergjente mjekësore dispeçerike

##### Neni 21

21.1. Qendrat e mëdha mund të kenë më shumë se një emergjencë mjekësore. Njëra nga këto duhet të organizohet si Qendër Dispeçerike, roli i së cilës do të jetë trajtimi i pacientëve emergjent në vendin e ngjarjes dhe transporti deri në Qendrën Emergjente spitalore dhe më tutje në nivelin terciar.

21.2. Qendrën dispeçerike e karakterizon numri i mjaftueshëm i ambulancave për të mbuluar tërë zonën shëndetësore komunale, të pajisura sipas protokollit.

21.3. Qendra Dispeçerike udhëheq me sistemin komunikues në rajonin e vet si dhe mbanë lidhjet komunikative me emergjencat tjera, në rend të parë me TMK-në, Policinë, Zjarrfikësit dhe me Qendrën Emergjente Universitare.

21.4. Qendra dispeçerike, kur të krijohen kushtet, duhet të këtë edhe Ambulancë Ajrore, ose Medikopter shtetëror ose privat, të pajisur sipas protokollit.

21.5. Qendra dispeçerike duhet të këtë kuadër profesional të trajnuar enkas për transportin tokësor dhe ajror të pacientëve emergjent.

21.6. Qendra dispeçerike e Prishtinës, në rast emergjencave masive, në bashkëpunim me Batalonin 40 të Mjekësisë së TMK-së, merr rolin kyç në evakuimin dhe ndihmën e popullatës së rrezikuar në tërë territorin e Kosovës.

21.7. Në situata të jashtëzakonshme, kjo qendër i nënshtrohet akteve nënligjore mbi situatat e jashtëzakonshme.

21.8. Financimi i Qendrës dispeçerike bëhet sipas Ligjit për Shëndetësi të Kosovës, nga Komuna, sigurimet shëndetësore dhe donacionet.

#### Neni 22

Shërbimin emergjent mjekësor në Kujdesin shëndetësor dytësor e përbën rrjeti i Departamenteve të emergjencave në Spitale.

#### Neni 23

Departamenti i emergjencës duhet të siguroj ekzaminim të hollësishëm mjekësor të të gjithë pacientëve që sjellën në një gjendje emergjente, stabilizimin e tyre dhe pranimin, ose transferin në Qendrën terciare pas stabilizimit.

#### Neni 24

Departamenti i emergjencës të një spitali, bënë stabilizimin e plotë të pacientëve emergjent, brenda kapaciteteve të institucionit.

#### Neni 25

Për stabilizimin e plotë të një gjendjeje emergjente, Departamenti i emergjencës mbështetët në përkrahjen e mjekëve specialist që disponon spitali. Në mungesë të kuadrit gjegjës dhe shtretërve, vetëm pas stabilizimit të pacientit emergjent, Departamenti mund të transferoj pacientin në spitalin tjetër.

#### Neni 26

26.1. Fushë veprimtaria e departamentit të emergjencës është si në Kapitulli V, neni 16.6

26.2. Veprimtarinë shëndetësore të Departamentit të emergjencës e kryejnë specialistët e emergjencës dhe të lëmive tjera të caktuara për trajtimin e pacientëve emergjent.

26.3. Secili Departament i emergjencës spitalore duhet të ketë:

- a. Bokset për ekzaminim, monitorim dhe trajtim të pacientëve emergjent.
- b. Aparaturat dhe mjetet e nevojshme për trajtim.

26.4. Departamenti i emergjencës spitalore punon me Protokollat e emergjencës spitalore.

26.5. Me Departamentin udhëheqë përgjegjësi i cili i referohet Drejtorit të spitalit Autoritetit shëndetësor dhe Zyrës për Shërbime emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë.

26.6. Financimi i Departamentit të emergjencës spitalore bëhet me linjën e veçantë për emergjencën mjekësore të Buxhetit të Ministrisë së Shëndetësisë.

## Transferi i pacientëve Neni 27

Transferi i pacientëve nga një spital në spital terciar dhe anasjelltas mund të bëhet pas plotësimit të këtyre kushteve:

- a) Pajtueshmëria e pacientit përveç në rastet me status mental të alteruar;
- b) Pas stabilizimit me mundësitë e spitalit;
- c) Pajtimi i mjekut që e pranon;
- d) Spitali që e pranon duhet të pajtohet dhe të sigurojë trajtim, nga spitali nuk kërkohet që të pranojë transferin nëse nuk ka kapacitet të duhur;
- e) Transporti i pacientit duhet të jetë i përshtatshëm me ambulancë të duhur dhe të kompletuar me pajisje dhe radiolidhje, me personel të trajnuar si duhet dhe me përcjellës të ambulancës;
- f) Kopjet e historisë të pacientit duhet të shkojnë bashkë me pacientin;
- g) Transferi mund të refuzohet për dy arsye:
  - 1). nuk ka vend të lirë;
  - 2). nuk ka specialist përkatës dhe pajisje adekuate për trajtim të pacientit.

## KAPITULLI VI EMERGJENCA MJEKËSORE UNIVERSITARE

### Neni 28

28.1. Departamenti Universitar i Emergjencës Mjekësore është institucion referent i emergjencës mjekësore në Kosovë, me seli në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, dhe paraqet sintezën e një kompleksi:

- a) Administrativ;
- b) Akademik dhe
- c) Klinik

28.2. Struktura administrative e Departamentit të emergjencës përkujdeset për:

- a) Certifikimin;
- b) Sistemin e pajisjeve;
- c) Sistemin informativ shëndetësor emergjent;
- d) Sistemin e Traumave;
- e) Komunikimin;
- f) Legjislacionin.

28.3. Në aspektin akademik, Departamenti i emergjencës bartë përgjegjësinë e vet:

- a) Aspektin universitar- raporti me Fakultetin e Mjekësisë në zhvillimin e specializimit në Mjekësinë Emergjente;
- b) Kultivon bashkëpunim të ngushtë me shkollën e Infermierisë (shkollën e Mesme dhe Fakultetin);
- c) Kryen trajnimet në kurset e Mjekësisë emergjente në të gjitha nivelet;

- d) Përkujdeset dhe përgatitë programin e specializimit;
- e) Zhvillon laboratorin e Shëndetit Publik;
- f) Kujdeset për edukimin e vazhdueshëm

28.4. Në aspektin klinik, Departamenti bashkërendit detyrat me:

- a) Spitalet, e veçmas me Departamentet e emergjencave të spitaleve;
- b) Me emergjencat mjekësore në Qendrat familjare;
- c) Me sistemin e Ambulancave;
- d) Me popullatën.

#### Neni 29

Departamenti universitar i emergjencës mjekësore përfshinë dhe zhvillon të gjitha lëmit e domosdoshme për trajtimin e pacientëve emergjent dhe kritik, stabilizimin e tyre, observimin deri në stabilizimin e kënaqshëm dhe transferin e tyre në repartet gjegjëse sipas gjendjes klinike, ose lëshimin në shtëpi pas stabilizimit definitiv:

- a) Qendrën Emergjente;
- b) Mjekimin Intensiv;
- c) Traumën;
- d) Observimin Internistik/kardiologjik;
- e) Observimin Toksikologjik;
- f) Diagnostikën laboratorike emergjente dhe toksikologjike;
- g) Diagnostikën rentgenologjike (Rtg. mobil dhe fiks, CT, Rezonancën Magnetike).

#### Neni 30

Për të gjitha këto njësi, Departamenti krijon kushtet e punës, siguron kuadrat gjegjëse dhe përpilon rregulloret dhe protokollet e punës.

#### Neni 31

Puna në Departament zhvillohet pandërprerë 24 orë, gjegjësisht në ndërrime 8, 12 dhe 24 orëshe.

#### Neni 32

Departamenti siguron kuadrat e veta mjekësore dhe në bashkëpunim me klinikat tjera organizon punën në kujdestari. Një pjesë e tyre mund të vendoset në sistemin e thirrjes.

#### Neni 33

Udhëheqësi i Departamentit bashkëpunon ngushtë me Drejtorin Mjekësor, Drejtorin Ekzekutiv dhe Zyrën për Shërbime emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë dhe për punën profesionale e organizative i referohet këtyre strukturave.

## Neni 34

Financimi i Departamentit bëhet nga linja buxhetore e veçantë në buxhetin e Institucionit përkatës, fondi i sigurimeve shëndetësore dhe nga Donacionet e ndryshme.

## KAPITULLI VII SISTEMI I TRAJTIMIT TË TRAUMËS

### Neni 35

35.1. Sistemi i trajtimit të traumës është një hallkë shumë e rëndësishme e Shërbimit të emergjencës mjekësore, me interes të veçantë shoqëror e strategjik.

35.2. Sistemi i trajtimit të traumës zbatohet në organizata emergjente të veçanta, Qendra Traumatologjike, në kuadër të Shërbimit emergjent mjekësor.

35.3. Sistemi i trajtimit të traumës në bazë të strategjisë zhvillimore, nevojave të qytetarëve për trajtim emergjent traumatik, zhvillimit urban, si dhe në bazë të pajisjeve dhe resurseve humane që posedojnë spitalet dhe Qendrat emergjente, organizohet në katër nivele:

- a) Niveli i Parë i trajtimit të traumës organizohet në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe në Spitalet e Kosovës, të cilat plotësojnë kriteret, sipas Protokollit mbi Nivelin e trajtimit të traumave, të cilin e përpilon Departamenti Universitar i Emergjencave mjekësore dhe e aprovon Bordi i trajtimit të traumave në nivelin e Ministrisë të Shëndetësisë.
- b) Niveli i Dytë i trajtimit të traumës organizohet në disa spitale të cilat kanë resurse humane dhe pajisje mjekësore të cilat kënaqin kriteret për Nivelin e dytë, sipas protokollit për organizimin e trajtimit të traumave.
- c) Niveli i Tretë i trajtimit të traumës organizohet në spitalet më të vogla të cilat sipas Protokollit mbi trajtimin e traumave plotësojnë kushtet për këtë nivel.
- d) Niveli i Katërt i trajtimit të traumës organizohet në emergjencën mjekësore paraspitalore, sipas protokollit mbi organizimin e trajtimit të traumave.

35.4. Zyra për emergjenca mjekësore në Ministrinë e Shëndetësisë udhëheq politikën shëndetësore në organizimin dhe zhvillimin e trajtimit të traumës mjekësore në Kosovë.

35.5. Zyra identifikon spitalet dhe përcakton nivelin e trajtimit të traumës për secilin spital.

35.6. Zyra po ashtu miraton plane dhe projekte të cilat kanë të bëjnë me trajtimin e traumës dhe prevencën e lëndimeve dhe merr të gjitha masat për edukimin e vazhdueshëm të resurseve mjekësore dhe popullatës në këtë aspekt.

35.7. Qendra Klinike Universitare e Kosovës dhe Spitalet janë të obliguara që të organizojnë shërbimin e trajtimit të traumës, sipas Protokollit për trajtimin e traumave në nivelin e përcaktuar.

## KAPITULLI VIII BASHKËPUNIMI ME EMERGJENCAT TJERA

### Neni 36

36.1. Shërbimi i mjekësisë emergjente, në të gjitha nivelet e organizimit të tij, detyrimisht kultivon bashkëpunim të ngushtë me emergjencat tjera, me Shërbimet mjekësore emergjente në rajon dhe në botë.

36.2. Bashkëpunimi me TMK-së, gjegjësisht Batalionin e 40 të shëndetësisë, zhvillohet gjithanshëm si në paqe, ashtu edhe në situata të jashtëzakonshme.

36.3. Me Shërbimin Policor të Kosovës, Shërbimi i mjekësisë emergjente bëhet në të gjitha nivelet, sidomos në fatkeqësitë e komunikacionit, lëndimet tjera dhe në situata të jashtëzakonshme.

36.4. Me Shërbimin e Zjarrfikësve, bashkëpunimi zhvillohet në nivelin paraspitalor, jo vetëm në rastet e zjarreve, por edhe ndihmohen në trajnime dhe kuadra.

36.5. Me Kryqin e Kuq të Kosovës, Shërbimi emergjent mjekësor, sidomos në nivelin paraspitalor, ndihmon në edukimin shëndetësor të popullatës, nxënësve të shkollave, dhe zhvillon forma të tjera bashkëpunimi në kushte emergjente.

36.6. Bashkëpunimi i ndërsjellë i niveleve të organizimit të Shërbimit shëndetësor ndodh pashmangshëm në kuptim të:

- a) Përfitimit të pacientëve emergjent në tërë territorin e Kosovës;
- b) Përfitimit dhe shkëmbimit të përvojave të njëri tjetrit;
- c) Emergjenca spitalore ndihmon gjithanshëm emergjencën paraspitalore;
- d) Departamenti Universitar i Emergjencës, vertikalisht dhe horizontalisht e ndihmon Shërbimin mjekësor emergjent në:
  - i shkollimin dhe trajnimin e kuadrit mjekësor;
  - ii përpilimin e Protokolleve profesionale spitalore dhe paraspitalore;
  - iii përpilimin e Rregulloreve të punës dhe akteve tjera nënligjore.

36.7. Bashkëpunimin ndërkombëtar, e udhëheq Departamenti Universitar i Emergjencës Mjekësore në kuptimin e ndërsjellët:

- a) në përfitimin e përvojave shkencore nga emergjencat mjekësore më të zhvilluara të kohës;
- b) në zhvillimin e Planprogrameve të specializimit;
- c) në edukimin dhe perfeksionimin e kuadrit mjekësor;
- d) në shkëmbimin e përvojave të ndërsjella në rajon;
- e) në organizimin e Simpoziumeve, Konferencave shkencore, profesionale dhe Kongreseve.

## KAPITULLI IX SISTEMI INFORMATIV SHËNDETËSOR NË EMERGJENCËN MJEKËSORE

### Neni 37

Sistemi informativ Shëndetësor në Shërbimin e Mjekësisë emergjente, i referohet Kapitullit të XI, të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

## KAPITULLI X SISTEMI I KOMUNIKIMIT NË EMERGJENCËN MJEKËSORE

### Neni 38

Sistemi i Komunikimit në Shërbimin e Emergjencës mjekësore (SKEM) është një komponentë e këtij shërbimi që i shërben pacientit dhe personelit mjekësor, për të fituar efektivitetin dhe profesionalizmin në këtë degë.

### Neni 39

SKEM shtrihet vertikalisht dhe horizontalisht në tërë kompleksin organizativ të Shërbimit emergjent mjekësor.

### Neni 40

SKEM shërbehet me 2 kode të veçanta radiovalësh dhe përmban aparaturë të sofistikuar për radiolidhje:

- a) Tokë-tokë dhe
- b) Tokë-ajër.

### Neni 41

Ky sistem funksionon sipas logjikës teknologjike me shifra për secilën njësi organizative dhe me:

- a) Bazat në Qendrat emergjente në nivelin primar dhe sekondar, në Qendrat Dispeçerike dhe në Departamentin Universitar të emergjencës;
- b) Njësitë në Ambulancat tokësore dhe ajrore.

### Neni 42

Shërbimi emergjent mjekësor përdor numrin e veçantë publik të telefonit.

Neni 43

Shërbimi emergjent mjekësor për nevoja të veta bashkëpunon edhe me Shërbimin e Telemjekësisë kosovare.

**KAPITULLI XI  
DISPOZITA TË VEÇANTA**

**Disiplina dhe përgjegjësitë  
Neni 44**

Disiplina dhe përgjegjësitë në punë i referohen Kapitullit XXIII, Neni 118,119 dhe Neni 120 të Ligjit për Shëndetësi të Kosovës.

**KAPITULLI XII  
DISPOZITAT KALIMTARE**

Neni 45

Të gjithë personat juridik dhe fizik të cilët në pajtim me nenin 1, ushtrojnë veprimtari shëndetësore, duhet të harmonizojnë organizimin dhe punën në pajtim me këtë Ligj.

Neni 46

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

**Ligji Nr. 02/L-50  
23 shkurt 2006**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës,**  

---

**akademik Nexhat Daci**